



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansija - Ministry of Finance

Thesari i Kosovës – Trezor Kosova - Treasury of Kosova

TË DHËNAT TRE-MUJORE MBI BORXHIN E PËRGJITHSHËM

Tremujori i Katërt

Janar 2015

Përmbajtja

| | |
|---|---|
| SHKURTESAT | 3 |
| BORXHI I PËRGJITHSHËM | 4 |
| Portofoli i borxhit sipas valutës..... | 5 |
| Portofoli i borxhit sipas llojit të interesit | 5 |
| BORXHI NDËRKOMBËTAR | 6 |
| BORXHI I BRENDSHËM | 7 |
| INDIKATORËT E RREZIKUT | 7 |

SHKURTESAT

- BPV - Bruto Produkti Vendor
- FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar
- IBRD - Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në kuadër të Bankës Botërore
- IDA - Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim në kuadër të Bankës Botërore
- KfW - Banka Zhvillimore në kuadër të Republikës Federale të Gjermanisë
- SDR - Të Drejtat Speciale për Tërheqje

BORXHI I PËRGJITHSHËM


Duke u bazuar në Ligjin për Borxhet Publike nr. 03/L-175 dhe Rregulloren QRK mbi Procedurat për Emetimin dhe Menaxhimin e Borxheve Shtetërore, Garancive Shtetërore dhe Borxheve Komunale Nr. 22/2013, Thesari publikon raportin *Të dhënat tre-mujore mbi Borxhin e Përgjithshëm*. Borxhi i Përgjithshëm përkufizohet me Ligjin për Borxhet Publik si, tërësia e Borxhit Shtetëror dhe Borxhit Komunal. Borxhi Shtetëror mund të jetë borxh i drejtpërdrejtë, apo borxh i nën-huazuar¹. Kurse sa i përket juridiksionit të cilit i nënshtrohet, Borxhi i Përgjithshëm mund të ndahet në Borxh Ndërkombëtar, dhe në Borxh të Brendshëm – ku Borxhi i Brendshëm i nënshtrohet juridiksionit vendor, ndërsa ai Ndërkombëtar mund t’u nënshtrohet edhe juridiksioneve jashtë Republikës së Kosovës.

Në fund të muajit dhjetor 2014 stoku i borxhit të përgjithshëm shënoi shumën 582.87 milion Euro apo 10.63% e BPV-së², nga të cilat Borxh Ndërkombëtar 326.35 milion Euro dhe Borxh i Brendshëm 256.52 milion Euro. Në Tabelën 1 shihet Borxhi i Përgjithshëm, i ndarë sipas llojit.

Tabela 1. Borxhi i Përgjithshëm (shumat janë në miliona euro)

| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 |
|--|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Borxhi Ndërkombëtar | 253.60 | 336.60 | 323.76 | 326.35 |
| Niveli Qendror | 253.55 | 336.46 | 321.73 | 316.54 |
| Nën-huazimet | 0.05 | 0.14 | 2.03 | 9.81 |
| Komunat | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Borxhi i Brendshëm | 0.00 | 73.31 | 152.51 | 256.52 |
| Niveli Qendror | 0.00 | 73.31 | 152.51 | 256.52 |
| Komunat | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm | 253.60 | 409.92 | 476.27 | 582.87 |
| Garancitë Shtetërore | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 10.00 |
| Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm (% e BPV-së) | 5.51% | 8.44% | 9.10% | 10.63% |

Grafikoni 1. Stoku i borxhit të përgjithshëm dhe si përqindje e BPV-së




¹ Borxh të cilin e kontraktin Qeveria, por që me një marrëveshje tre-palëshe ka të drejtë ta nën-huazojë te një entitet i sektorit publik.

² Sipas Nenit 5, Ligji për Borxhet Publike nr. 03/L-175, llogaritja e % ndaj BPV duhet të përfshijë edhe Garancitë.

Portofoli i borxhit sipas valutës

Në fund të 2014, rreth 76.7³ milion Euro apo 13% e portofolit të borxhit është e ekspozuar ndaj rrezikut valutor, kjo pasi që kreditë e huazuara nga FMN dhe IDA janë në valutë SDR⁴. Ndërsa, pjesa tjetër 87% e portofolit të borxhit është në valutën Euro, siç shihet në grafikoni 2.


Grafikoni 2. Përbërja e Borxhit të Përgjithshëm sipas valutës



Portofoli i borxhit sipas llojit të interesit

Pjesa e portofolit të borxhit e cila është e ekspozuar ndaj rrezikut të interesit përbëhet nga borxhi që i detyrohem FMN-së. Kështu në fund të 2014, rreth 17% e portofolit të borxhit është i ekspozuar ndaj rrezikut të interesit, si shihet më poshtë në grafikoni 3.

Grafikoni 3. Përbërja e Borxhit të Përgjithshëm sipas llojit të interesit




³ Është vlera neto e ekspozuar, e cila nënkupton shumën e ekspozuar duke përjashtuar komponentin Euro.

⁴ SDR është një 'shportë' monedhash e cila përbëhet nga monedhat e mëposhtme: EUR, USD, GBP, dhe JPY. Vlera e SDR përcaktohet në bazë të një mesatare e cila është tërhequr nga vlerat e monedhave të përmendura më lart.

BORXHI NDËRKOMBËTAR


Në fund të vitit 2014 Borxhi Ndërkombëtar ishte 326.35 milion Euro, që njëherazi përbën 56% të portofolit të borxhit. Pjesa më e madhe e borxhit vazhdon të jetë ndaj IBRD-së, ndërsa pjesa tjetër e konsiderueshme është borxh ndaj FMN-së. Në Grafikonin 4 shihet përbërja e Borxhit Ndërkombëtar sipas kreditorëve.

Grafikoni 4. Borxhi ndërkombëtar i ndarë sipas kreditorëve



Në fund të tremujorit të katërt të 2014, pjesa më e madhe e Borxhit Ndërkombëtar ishte kryesisht në valutën Euro, kurse pjesa tjetër në SDR. Kryesisht kreditë e huazuara nga IDA dhe FMN janë në valutën SDR, kurse kreditë nga IBRD, KfW⁵ dhe UniCredit Austria janë në valutën Euro.

Grafikoni 5. Borxhi Ndërkombëtar sipas valutës




⁵ Kreditanstalt für Wiederaufbau

BORXHI I BRENDSHËM

Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2014 Borxhi i Brendshëm ishte në shumën 256.5 milion euro apo 44% e portofolit të borxhit. Në vijim në grafikonin 6 shihet kompozimi i Borxhit të Brendshëm sipas instrumentit.

Grafikoni 6. Borxhi i Brendshëm i ndarë sipas llojit të instrumentit



INDIKATORËT E RREZIKUT

Tabela 2. Indikatorët e rrezikut

| | 2012 | 2013 | 2014 |
|--|--------|--------|--------|
| Borxhi i përgjithshëm/BPV⁶ | 8.44% | 9.08% | 10.63% |
| <i>Borxhi Ndërkombëtar</i> | 6.93% | 6.17% | 5.85% |
| <i>Borxhi i Brendshëm</i> | 1.51% | 2.91% | 4.59% |
| Koha mesatare deri në maturim për borxhin e përgjithshëm (vite) | 11.51 | 9.24 | 5.20* |
| <i>Borxhi Ndërkombëtar (vite)</i> | 14.00 | 13.42 | 7.79 |
| <i>Borxhi i Brendshëm (muaj)</i> | 1.53 | 4.28 | 8.13 |
| % e Borxhit të Përgjithshëm | 100% | 100% | 100% |
| <i>Borxhi Ndërkombëtar</i> | 82.12% | 67.98% | 56.00% |
| <i>Borxhi i Brendshëm</i> | 17.88% | 32.02% | 44.00% |

⁶ Përfshin edhe Garancitë.

* Ndryshim në Metodologji – Llogaritja e mëparshme është bërë duke marrë për bazë datën e pagesës së këstit të fundit. Kurse tani e tutje llogaritja bëhet duke marrë për bazë datat aktuale të pagesës së secilit këst.